R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E AKREDITIMIT
Sektori i Financës dhe Shërbimeve

Nr._____prot. **Tiranë më 06.12.2026**

Lënda: Dërgohet raporti i monitorimit të buxhetit 12 mujor 2025

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
Drejtoria e Menaxhimit te Buxhetit
(Adresa: Dëshmorët e 4 shkurit,Tiranë)
Tiranë

DPA është i vetmi organizëm kombëtar i akreditimit i cili kryen akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Shqipëri.
DPA ka Objekt të Aktivitetit Lëshimin e Çertifikata Akreditimi të njohura në vendet ndërkombëtare.
DPA akrediton laboratorë testues, laboratorë kalibrues, laboratorë mjekësorë, organe të çertifikimit të sistemeve të menaxhimit, organet çertifikuese të personave dhe trupat inspektuese.
Sipas organigramës miratuar nga K/M nr.2 datë 12.01.2021 indryshuar me Urdherin nr.139 prot,datë 26.09.2023 struktura e DPA-s është 20 punonjes i miratuar, dhe aktualisht jemi 20 punonjes si dhe 5 punonjës me kontratë 6 orë.
Në zbatim të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 ‘’Për Menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë,të ndryshuar me Ligjin nr.115/2024, ‘’Për buxhetin e vitit 2025’’,Udhëzimit plotësues të Ministrit Financave nr.2,datë 24.01.2025 ‘’Për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2025 ‘’
Treguesit Financiar për 12 mujorin 2025 janë si më poshtë:

Buxheti vjetor i akorduar për DPA, konsiston në mbështetjen logjistike të ushtrimit të kompetencave e funksioneve të institucionit, për arritjen e objektivat e përcaktuara.

Objektivat e programit buxhetor akorduar në periudhën 2025 për DPA, konsistojnë në zbatimin e kërkesave Ligjit 116/2014 ‘’Për Akreditimin e Organeve Të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

Buxheti i vitit 2025, shkon për shpenzime koherente . Fond për investime kapitale nuk janë akorduar

Tabela 1 Plani buxhetor 2025 dhe zërat të shpenzimeve kundrejt totalit:

Në mijë lekë

Nr.	EMËRTIMI	PLANI BUXHETOR	REALIZUAR 12 mujori 2025
1	Paga	35.000	34.432
2	Sigurime shoqërore	6.000	5.449
3	Mallra e shërbime të tjera	4.000	3.800
4	Transferta Korente të Huaja	2.500	2.182
5	Transferta tek individët dhe familjet	140 47.648	134 45.986

Nga fondi planifikuar për 12 mujorin zerin 600-601,për pagat dhe sigurimet shoqerore prej **35.000 mijë lekë** , DPA ka shpenzuar ***vleren 34.432*** **mijë *lekë***. Buxheti është realizuar në masën 98.3**% te planit vjetor.**

Në zërat e buxhetit fondi 600-601 paga, realizimi përfshin vlerat e pagave të stafit dhe shtesat mbi pagë, si dhe vlerat e paguara për punonjësit me kontratë të përkohshme si dhe zërin 601 kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetesore e cila përfaqëson derdhjen 16.7% të kontributeve në fondin e sigurimeve.

Në zërin 602-606 mallra dhe shërbime,kuata antarsimi, transferta te individe dhe fondi i veçantë, fondi i planifikuar mijë lekë është 6.648 mije lekë, realizuar 6.106 mije leke ose 92% përfshihen vlerat për udhëtime dhe dieta, karburant,mallra kancelari, pastrim dhe shërbime nga të tretë.Në zërn 605 realizuar jane kuata të Anatarsimit të DPA-s, në Organizmat e EA, ILAF,ILAC.

Zëri 606, kemi planifikuar 140 mije leke dhe realizuar 134 mije leke,ose 96% shpenzime për transferta te individë .

Bazuar ne Ligjin Nr.92/2023, neni 5 e tij ,Dpa realizon të Ardhura nga ofrimi i shërbimeve të cilat përdoren në masën 90% për mbulimin e shpenzimeve për audituesit,vleresuesit,trajnimet,pronovimet dhe përmirësimin e infrastrukturë së akreditimit.

Gjatë 12 mujorit të vitit 2025 janë buxhetuar 20.151mije lekë dhe përdorur 8.950 mije lekë, shpenzime nga të ardhurat e Institucionit.

Treguesit e performancës janë si më poshtë:

Numri i OVK të akredituar deri më 31.12.2025 janë:

-119 Organe të Vlerësimit të Konformitetit, nga të cilët:
-58 Laburator testues
-1 Laburator Kalibrues
-7 Laburator Mjekësor
-27 Trupa Inspektuese
-14 Trupa Çertifikim Personi
-13 Trupa për Sistemet e Menaxhimit

Buxheti për shpenzimet koherente gjatë 12 mujorit të vitit 2025,është zbatuar me korrektesi me gjithë detyrimet që rrjedhin nga Ligji 9936 datë 26.06.2008 ‘’Për Menxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH ‘’ si dhe legjislacionin administrativo –financiar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

PRANVERA FAGU

Konceptoi:Tatjana Xhafa
06.01.2026